



Udhëzuesi për aplikim për grante për projekte në fushën tematike të raportimit të drejtë në gazetari

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në kuadër të skemës për përkrahje të shoqërisë civile financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut (këtej e tutje referuar si skema e Luksemburgut), hapë thirrjen për aplikim për grante për projekte në fushën tematike të raportimit të drejtë në gazetari. Të drejtë aplikimi kanë të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) vendore¹, aktive, të regjistruara në Kosovë. Afati i fundit për aplikim është data **9 mars 2018, ora 23:59**.

Përmbledhje e shkurtër e skemës së Luksemburgut

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj skeme është të përkrahë iniciativat e shoqërisë civile në Kosovë, përmes mbështetjes financiare të OJQ-ve, në këto fusha të përzgjedhura tematike:

1. Integrimi social i të rinjve;
2. **Përkrahja e raportimit të drejtë në gazetari;**
3. Rritja e njohurive mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe Integritimit Evropian.

Skema do të mbështesë OJQ-të të cilat paraqesin propozime të plota dhe bindëse që kontribuojnë në arritjen e rezultateve konkrete, përderisa roli i gruas, barazia gjinore dhe integrimi i minoriteteve duhet të mbështetet dhe promovohet sistematikisht në të gjitha aktivitetet.

Të arriturat përfundimtare të fushave tematike të përkrahura nga kjo skemë pritet të kontribuojnë në arritjen e këtyre rezultateve:

1. Rritje e përfshirjes dhe kontributit të OJQ-ve në fushat tematike të paraqitura më lartë;
2. Fuqizimi i bashkëpunimit mes shoqërisë civile, qytetarëve dhe institucioneve publike;
3. Fuqizimi i rolit të gruas përmes përfshirjes në nisma me bazë në komunitet dhe procese politikë-bërëse.

Ky dokument është hartuar për qëllime të projektit 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

I. Raportimi i drejtë në gazetari

i. Hyrje

¹ Sipas definicionit në Ligjin për lirinë e asociimit në Organizatat Jo-qeveritare.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e shprehjes, të drejtën për qasje në dokumente zyrtare, lirinë dhe pluralizmin e mediave dhe ndalon censurën. Por, informatat e mbledhura gjatë fazës fillestare të skemës tregojnë se mungesa e pavarësisë financiare të mediave, gazetarëve që nuk janë të trajnuar mirë për përgatitjen e lajmeve cilësore, respektimi jo i mjaftueshëm i etikës në raportim, dhe sfida të tjera, kanë ndikuar në cilësinë e raportimit të mediave në Kosovë. Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe kuptimit të rëndësisë së lirisë së medias nga publiku, gazetarëve apo personelit tjetër të medias u është dhënë shumë pak mbrojtje.² Ekzistojnë prova të mjaftueshme për të theksuar se gjykatat kërkojnë vite për të trajtuar rastet; zyrtarët publik vazhdojnë të mos respektojnë gazetarët, si dhe t'i fyejnë dhe kërcënojnë ata; dhe qasja në dokumente publike është e kufizuar. Për pasojë, gazetarët vazhdojnë të ndjehen se nuk janë as të lirë dhe as të mbrojtur në ushtrimin e punës së tyre.

Indeksi i qëndrueshmërisë së medias botuar nga IREX tregon se Kosova mund të karakterizohet si ambient medial afërsisht i qëndrueshëm. Freedom House në raportin e saj të fundit mbi lirinë e shtypit vlerëson se Kosova është "pjesërisht e lirë". Sipas Freedom House, Kosova ka një kornizë ligjore me cilësi të lartë që siguron lirinë e mediave dhe ofron në letër disa nga standardet më të larta të mbrojtjes gazetareske. Sidoqoftë, informatat nga terreni tregojnë se shumë gazetarë, veçanërisht gazetarët me më pak përvojë, nuk kanë informata të plota për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre gjatë raportimit, ndërkohë që rënia e zbatimit të kodit etik nga gazetarët është shqetësuese. Për më tepër, intervistat e realizuara me akterë të kësaj fushe tregojnë se të diplomuarit e gazetarisë në universitetet e Kosovës nuk janë të trajnuar në mënyrë të duhur dhe kanë mungesë të shkathtësive themelore dhe etikës së nevojshme për raportim në përputhje me praktikën më të mira. Për më tepër, edhe kur gazetarët e rinj fillojnë të punojnë në media, nuk trajnohen për praktikën më të mira të raportimit, balancimin e lajmeve të raportuara dhe kontrollimin e fakteve.

Megjithëse organet rregullative kanë kodin e etikës, ekziston prirje për zbatim të ultë të tyre. Pak media kanë doracakë të raportimit të brendshëm dhe kode etike, ndërkohë që viteve të fundit numri i ankesave lidhur me etikën ndaj mediave 'online' është rritur. Çështjet gjinore dhe ato të pakicave nuk mbulojnë në mënyrë të duhur e të mjaftueshme nga mediat. Kjo kryesisht për shkak se mediat janë shumë të përqendruara në raportimin e çështjeve politike, ndërsa temat e tilla janë më pak të mbuluara.

ii. Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj fushe tematike është përmirësimi i raportimit të drejtë në gazetari përmes arritjes së objektivave në vijim, në kuadër të fushave prioritare të paraqitura më poshtë:

O1: Profesionalizmi në media për të zhvilluar dhe respektuar standardet etike dhe profesionale është përmirësuar:

1.1 Gazetarët kanë kapacitete të përmirësuara në lidhje me standardet profesionale dhe etike

² <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2017/kosovo>.

O2: Gazetaria huluntuese përmes shkëmbimit të përvojave është përmirësuar:

2.1 Gazetarët e Kosovës bashkëpunojnë me kolegët e tyre në mediat e njohura ndërkombëtarisht

2.2 Gazetarët në media të ndryshme kanë ekspertizë të veçantë tematike

O3: Zbatimi i kornizës ligjore dhe cilësisë së raportimit është përmirësuar:

3.1 Zbatimi i legjislacionit monitorohet dhe ndërmirren nisma të avokimit për çështjet e identifikuara

3.2 Mekanizmi për raportim të lajmeve jo cilësore është themeluar dhe është funksional

Organizatave mund të aplikojnë në njërin objektiv, me mundësi kombinimi ndërmjet fushave prioritare përkatëse.

iii. Fushat prioritare për intervenim

O1: Profesionalizmi në media për të zhvilluar dhe respektuar standardet etike dhe profesionale është përmirësuar

1.1 Gazetarët kanë kapacitete të përmirësuara në lidhje me standardet profesionale dhe etike

Intervenimet në këtë fushë prioritare duhet të sigurojnë kuptimin e drejtë të bazave të raportimit etik dhe aplikimin e kodit të etikës dhe standardeve profesionale nga ana e gazetarëve, redaktorëve, pronarëve. Situata ekzistuese tregon nevojën për pajtueshmëri të aktorëve mbi atë se çfarë mund të publikohet në media dhe çfarë jo, si të verifikohen informatat në epokën dixhitale, çështja e vetë-rregullimit medial në epokën dixhitale, trajnimi i stafit teknik (fotografë, kameraman, redaktorë të videove, dizajner grafik etj.), për të siguruar gjithashtu që imazhet dhe pamjet që publikohen në media nuk shkelin kodin e etikës. Fokus i intervenimit duhet të jenë gazetarët e rinjë dhe pa përvojë.

Përmirësimi i njohurive mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e gazetarëve, me bazë në legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare, përmes udhëzuesve³ ligjorë, është një tjetër element që ndikon në avancimin e standardeve profesionale dhe etike. Trajtimi i çështjeve si: shpifja, mbrojtja e burimeve, qasja në informata, raportimi nga gjykatat, përdorimi i të dhënave personale, e drejta e pronësisë intelektuale, mbrojtja e privatësisë, mbrojtja e mediave, rregullatorët e medias dhe vetë-rregulluesit është veçanërisht i dobishëm për mediat jashtë Prishtinës, të cilat operojnë me më pak kapacitete profesionale, menaxheriale dhe financiare.

O2: Gazetaria huluntuese përmes shkëmbimit të përvojave është përmirësuar

2.1 Gazetarët e Kosovës bashkëpunojnë me kolegët e tyre në mediat e njohura ndërkombëtarisht

Përvoja e shkëmbimit me homologët rajonal dhe / ose të BE-së është gjithashtu një mënyrë që mund të ndikojë në rritjen e profesionalizmit në media, përmes mësimit të parimeve themelore dhe trendeve aktuale në gazetari. Për më tepër, kjo do të mund të ishte mundësi e mirë për krijim të bashkëpunimit edhe në tema sektoriale.

³ Në anglisht: *toolkits*

2.2 *Gazetarët në media të ndryshme kanë ekspertizë të veçantë tematike*

Ekspertiza tematike është një nga elementet më të rëndësishme të raportimit cilësor në gazetari. Mungesa e kësaj ekspertize rezulton me mungesë të analizës së thellë të çështjeve që trajtohen të cilat do të mund të nxisin debat publik. Për shembull, kur shkruajnë për sfidat me të cilat ballafaqohen të papunët për të hyrë në tregun e punës në Kosovë, gazetarët janë rrallë të vetëdijshëm për specifikat dhe nuk shpjegojnë implikimet e treguesit kryesor të tregut të punës të shpallur në baza tremujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Mungesa e njohurive të specializuara dobëson si përmbajtjen ashtu edhe besueshmërinë e asaj që raportohet. Të kuptuarit e duhur të proceseve siç është Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, agjenda e reformës ekonomike, migrimi i rregulltë, ekstremizmi dhe radikalizmi, marrëveshjet e Brukselit, reforma në arsimin e lartë, diskriminimi në baza gjinore, tregu i punës dhe punësimi etj., do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së raportimit në media.

03: Zbatimi i kornizës ligjore dhe cilësisë së raportimit është përmirësuar

3.1 Zbatimi i legjislacionit monitorohet dhe ndërmirren nisma të avokimit për çështjet e identifikuara

Korniza ligjore që rregullon rolin e medias dhe produkteve mediale rrallë monitorohet sistematikisht. Disa nga ligjet që ndikojnë në cilësinë e raportimit dhe rrjedhimisht do të duhej monitoruar janë: Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligji për Qasjen në Dokumente Publike, Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligji i Punës dhe Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Monitorimi duhet të vlerësojë gjithashtu nëse ka nevojë për reformë ligjore për të përmirësuar gjendjen e mediave në Kosovë, duke vlerësuar se sa respektohet / shkelet legjislacioni ekzistues, dhe cilët janë hapat e ardhshëm që do të duhej të ndërmirren për të ndihmuar mediat në zhvillimin e standardeve profesionale dhe kodeve etike. Po ashtu do të duhej të përfshijë respektimin e detyrimeve mbi saktësinë e raportimit, paanshmërinë dhe objektivitetin, si dhe respektimin e privatësisë. Rrjedhimisht, të arriturat në këtë fushë prioritare do të vlerësohen përmes numrit të ligjeve të monitoruara dhe nismave të avokimit të ndërmarrura.

3.2 Mekanizmi për raportim të lajmeve jo cilësore është themeluar dhe është funksional

Në përgjithësi, qytetarët e Kosovës nuk e kanë shumë të qartë rolin e medias në shoqëri për shkak se kjo nuk është pjesë e plan-programit arsimor. Për më tepër, për shkak të rritjes së përdorimit të rrjeteve sociale si burime kryesore të lajmeve, shumë prej tyre e kanë të vështirë të dallojnë lajmet e vërteta prej atyre të rrejshme dhe të vlerësojnë cilësinë e lajmeve ndaj të cilave janë të ekspozuar. Andaj, krijimi apo avancimi i mekanizmave ekzistues ku profesionistët dhe qytetarët do të mund të raportojnë dhe analizonin raportimin e anshëm, jo të saktë dhe të rrejshëm, do të nxiste angazhimin publik në monitorimin e cilësisë së raportimit.

iv. Të arriturat kryesore

Aplikacionet duhet të specifikojnë të arriturat kryesore të synuara⁴ të cilat duhet të jenë të arritshme dhe të matshme dhe t'i shërbejnë arritjes së objektivave. Gjithashtu, logjika e intervenimit dhe aktivitetet duhet të jenë të ndërlidhura qartë me të arriturat kryesore brenda afatit të propozuar.

v. Përfituesit e synuar

Aplikacionet duhet të synojnë kryesisht gazetarët dhe redaktorët e përkushtuar, me ndarje të barabartë gjinore dhe shtrirje në nivel vendi. Përrjashtimet në parim nuk lejohen, por mund të pranohenvetëm në raste të ralla me shpjegim të qartë të nevojës për përrjashtim. Kurdo që është e mundshme, qasje e njejtë duhet të aplikohet edhe për përrfshirjen e grupeve minoritare.

vi. Intervenimet/aktivitetet e papranueshme

Intervenimet e mëposhtme nuk do të përrkrahën përrmes kësaj skeme:

- Intervenimet me ndërlidhje të drejtpërrdrejt apo në përrkrahje të partive politike;
- Ndihma emergjente apo bamirësitë;
- Investimet kapitale;
- Bursat e shkollimit jashtë vendit.

Në parim, skema nuk do të përrkrahë aktivitetet e paraqitura më poshtë, përrveç rasteve kur ato janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve të synuara:

- Organizimin e konferencave apo tryezave;
- Realizimin e hulumtimeve dhe studimeve të fizibilitetit, veçanërisht para fillimit të aktiviteve të parapara;
- Vizitat studimore jashtë Kosovës.

vii. Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant

Organizatata aplikuese mund të aplikojnë me vetëm një aplikacion. Të përrzgjedhurit, qofshin ato organizata bartëse apo partner të synuar për zbatim, nuk mund të përrfitojnë nga më shumë se një (1) grant paralelisht.

viii. Kohëzgjatja dhe buxheti

Kohëzgjatja maksimale për grant është **24 muaj** ndërsa buxheti tentativ i paraparë për këtë thirrje është 200,000 Euro dhe planifikohet të përrkrahën 4 – 6 organizata/grante. Kohëzgjatja e aktiviteve duhet të arsyetohet ndërsa buxheti duhet të jetë real dhe të sigurojë zbatim cilësor të aktiviteve.

ix. Dokumentet për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Aplikantët duhet të plotësojnë aplikacionin, kornizën logjike, planin e aktiviteve dhe buxhetin duke respektuar formularët përrkatës. Aplikacionet e kompletuara duhet të dorëzohen vetëm në formë

⁴ Në anglisht: *project milestones*

elektronike në formatin pdf ose word në kcsfluxaplikimi@kcsfoundation.org. Bashkë me dokumentet e lartpërmendura aplikantët duhet të dërgojnë edhe certifikatën e regjistrimit të OJQ-së.

Në rast se parashikohet bashkëpunim me institucione publike, dhe ky bashkëpunim është parakusht për zbatimin e aktiviteteteve, aplikanti duhet të dërgoj Memorandumin e Bashkëpunimit që dëshmon këtë bashkëpunim.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

x. Vlerësimi

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet bazuar në kriteret e paraqitura më poshtë. Vlerësimi bëhet nga Bordi Vlerësues i pavarur i përbërë nga anëtarë me njohuri dhe ekspertizë në fushën përkatëse.

Kriteret për vlerësim

I. Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante (25%)

- i. Kapacitetet organizative dhe teknike (personeli, biografia e shkurtër e personelit kyç për zbatim (keni parasysh se përfshirja e grave do të vlerësohet me më shumë pikë), infrastruktura e përshtatshme për zbatimin e intervenimit të propozuar, kapaciteti për menaxhim financiar);*
- ii. Relevanca e përvojës paraprake.*

II. Propozimi/aplikacioni (50%)

Ndërlidhja e idesë me objektivin dhe fushën(at) prioritare të përzgjedhur(a) do të jetë kushti kryesor për shqyrtim të aplikacionit. Kjo nënkupton që vetëm aplikacionet të cilat e plotësojnë këtë kusht do t'i nënshtrohen vlerësimit të cilësisë sipas kriterëve të paraqitura më poshtë.

- i. Analiza e nevojës dhe mundësive për intervenim;*
- ii. Metodologjia, qasja dhe plani i zbatimit (aktivitetet);*
- iii. Metodologjia për qasje në komunitet dhe angazhimin e tyre;*
- iv. Të arriturat kryesore duke specifikuar rezultatet konkrete dhe të matshme që synohen të arrihen përmes intervenimit;*
- v. Prezantimin dhe shpjegimin e aktiviteteteve, përfshirë masat e propozuara për të siguruar mbështetje dhe promovim sistematik të rolit të gruas, barazisë gjinore dhe integritit të minoriteteve;*
- vi. Informatat mbi përfituesit e synuar me fokus te grupet e ndjeshme, përfshirë ndarjen në bazë të moshës, gjinisë dhe rajonit;*
- vii. Identifikimin e palëve të përfshira dhe shpjegimin e rolit të tyre në zbatim;*
- viii. Mundësinë për replikim dhe zgjerim të aktiviteteteve;*
- ix. Prezantim të metodës së monitorimit dhe definim të qartë të treguesve të propozuar për të matur cilësinë dhe kohën e zbatimit;*

- x. *Rreziqet potenciale që mund të ndikojnë negativisht në zbatim, përfshirë informatat mbi gjasat e shfaqjes (lartë, mesatare apo ulët) dhe masat e propozuara për evitimin e tyre.*

III. Buxheti (25%)

- i. *Efektiviteti i buxhetit të propozuar.*

Maksimumi i pikëve të arritshme është 100, ndërsa pragu minimal i kalueshmërisë është 70 pikë.

xi. Njoftimi i vendimit

Të gjithë aplikantët do të informohen për rezultatet e vlerësimit pas shqyrtimit të aplikacioneve nga Bordi.

xii. Kontakti

Për pyetje eventuale rreth përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për aplikim mund të na kontaktoni në kcsflux@kcsfoundation.org jo më larg se 28 shkurt 2018. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në webfaqe të KCSF-së.